

KY DOKUMENT PARAQET PËRFAQËSIMIN
E SHQIPTARËVE NË TË GJITHA
INSTITUCIONET REPREZENTATIVE E
DALURA NGA VOTA

GJENDJA PËR VITIN 2021

PËRFAQËSIMI

I SHQIPTARËVE TË LUGINËS SË
PRESHEVËS

Ragmi Mustafi

Këshilli Komëtar Shqiptar

PËRFAQËSIMI

I SHQIPTARËVE TË LUGINËS SË PRESHEVËS

Këshilli Kombëtar Shqiptar (KKSH) në Serbi është organ përfaqësues i pakicës kombëtare shqiptare në Republikën e Serbisë, përmes së cilës anëtarët e pakicës kombëtare shqiptare ushtrojnë të drejta për vetëqeverisjen e pakicave, në fushat e kulturës, arsimit, informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe dhe shkrimit të saj.

autorë:

Ragmi Mustafi dhe ekipi i KKSH-së

Kontribuuesit do të donin të falënderonin të gjithë ata, që dhanë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për të studiuar,

Copyright

© Këshilli Kombëtar Shqiptar (KKSH), 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem rikthimi, ose të transmetohet në asnjë formë ose mjet, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndonjë formë tjetër pa lejen paraprake të KKSH-së.

Këshilli Kombëtar Shqiptar

Përmbajtja	
AKRONIMET	5
PARATHËNIE	6
Metodologji.....	6
TË DHËNAT E PËRGJITHSHME	7
2002 regjistrimi i vetëm	7
Regjistrimi 2011	7
Të dhënat gjeografike për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë	8
Presheva.....	8
Bujanoci.....	8
Medvegja	8
PARTITË POLITIKE SHQIPTARE	9
INSTITUCIONET PËRFAQËSUESE	10
PËRFAQËSIMI NË PARALMENTIN E REPUBLIKËS SË SERBISË	10
PËRFAQËSIMI NË KËSHILLIN KOMBËTAR SHQIPTAR	11
PËRFAQËSIMI I KOMUNËS SË PRESHEVËS	11
PËRFAQËSIMI I KOMUNËS SË BUJANOCIT	12
PËRFAQËSIMI I KOMUNËS SË MEDVEGJËS	12
TABELAT DHE FIGURAT	13
Literatura.....	19

AKRONIMET

AFEDS - Forumi shqiptar për zhvillim ekonomik në Serbi

APN – Alternativa për Ndryshime

KK - Kuvendi Komunal

KKSH – Këshilli Kombëtar Shqiptar

LPD – Lëvizja e Progresit Demokratik

LR - Lëvizja për Reforma e

LS - Lista Serbe

PD – Partia Demokratike

PDSH – Partia Demokratike Shqiptar

PRS - Parlamenti i Republikës së Serbisë

PUPS - Partia e Penzionerëve të Bashkuar të Serbisë

PVD – Partia për Veprim Demokratik

SD - E djathta Serbe

SNS - Partia Përparimtare Serbe

SRS - Partia Radikale Serbe

UDSH-

-

PARATHËNIE

Ky hulumtim bazë, ka për qëllim pasqyrimin e gjendjes së përfaqësimit të shqiptarëve në Serbi, përkatësisht të shqiptarëve në Luginën e Preshevës në institucionet përfaqësuese. Hulumtimi është përcaktuar në përfaqësimin e organeve dhe institucioneve të dala nga ciklet elektorale:

- Në zgjedhjet komunale për komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës;
- Në zgjedhjet e veçanta për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, dhe
- Në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare për Parlamentin e Republikë së Serbisë

Është zhvilluar si pjesë e nevojës për të dhëna të sakta mbi përfaqësimin dhe votën e marrë në zgjedhjet e drejtpërdrejta. Për të ridefinuar politikat përfaqësuese për komunitetin shqiptar. Si prioritet kyç i KKSH-së është ruajtja identitetit kombëtar dhe avancimi i pozitës së gjithmbarshme të shqiptarëve në Luginën e Preshevës.

Synim i këtij dokumenti është të sigurojë një studim bazë mbi përfaqësimin aktual të shqiptarëve në Komuna, Parlament dhe KKSH, në mënyrë që të lejojë monitorimin dhe vlerësimin e bazuar në fakte, si dhe të sigurojë tregues adekuat për vlerësimin e përfaqësimit për Preshevën, Bujanoc dhe Medvegjë.

Studimi bazohet në të dhënat e mbledhura gjatë hulumtimit të kryer direkt nga raportet zgjedhore në zgjedhjet e mbarë vajtuar ku shqiptarët kanë marrë pjesë brenda sistemit juridiko-politik të Republikës së Serbisë.

Metodologji

Në përgatitjet për realizimin e hulumtimit janë përdorur të dhënat mbi formimin e grupeve të këshilltarëve në kuvendet komunal, të dhënat nga certifikimi i komisioneve komunale, të dhënat nga certifikimi i komisionit republikan zgjedhor zgjedhore informacionet.

Realizimi i objektivave e ka kushtëzuar aplikimin e disa metodave dhe teknikave shkencore. Teknologjitë informative kanë mundësuar klasifikimin dhe skedimin racional dhe efikas të burimeve të ndryshme që lidhen me këtë temën.

Të dhënat u kategorizuan në atë mënyrë që të sigurojnë pasqyrimin real të situatës në terren.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Nga të dhënat e përgjithshme, strukturat: si ajo biologjike, arsimore, gjuhësore, fetare, politike, social-ekonomike etj., tregojnë shkallë të lartë të homogjenitetit dhe njëtrajtshmërisë në gjithë rajonin, me mbizotërimin e popullsisë së moshës së re, të besimit mysliman, me mbizotërim të theksuar të popullsisë rurale, përqindje të lartë të popullsisë bujqësore, raport të pafavorshëm të popullsisë aktive me atë të mbajtur, shpërndarje shpërpjesëtimore të popullsisë aktive sipas sektorëve të veprimtarisë, me përqendrim kryesisht në atë primar etj.

Politikat ndaj shqiptarëve në Serbi, që pas vitit 2011 janë lidhur rreth numrit. Në vazhdimësi është kontestuar numri i shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë nga politikanë lokal serbë. Megjithatë, Regjistrimi popullsisë i vitit 2002 në Republikën e Serbisë kishte zbehur debat për komunën e Preshevës dhe Medvegjës, por jo edhe debatin dhe kontestimin e numrit të banorëve shqiptarë në Bujanoc, ku edhe më tej kontestohet shumica shqiptare e kësaj komune. Nga ky regjistrim shqiptarët në nivel të Republikës së Serbisë ishin 0.86%. Fondi për të Drejtën Humanitare patë vlerësuar se ka rreth 100.000¹ shqiptarë në Serbi (Фонд за хуманитарно право, 2004), gjithashtu edhe politikanët shqiptarë nga Lugina e Preshevës në vazhdimësi kanë kumtuar se ka rreth 110.000 shqiptarë duke u bazuar se edhe një numër i madh i shqiptarëve nga këto treva jetojnë dhe veprojnë në diasporë.

2002 regjistrimi i vetëm

Regjistrimi i parë i popullsisë, në të cilin ka marrë pjesë edhe komuniteti shqiptar në Luginë të Preshevës është regjistrimi i vitit 2002, të cilin e parashihte “Plani i Çoviqit”. Ky regjistrim është i rëndësishëm së veçantë, mes tjerash, edhe për faktin se i mundësoi shqiptarëve që të integrohen përpjesëtimisht në strukturat e pushtetit lokal në komunën e Bujanocit, në zgjedhjet e parakohshme të mbajtura më vitin 2002, pak kohë pas këtij regjistrimi. Por mangësitë e tij janë mos përfshirja e të dëbuarve nga Lugina e Preshevës në Kosovë.

Regjistrimi 2011

Regjistrimin e popullsisë të viti 2011 në Republikën e Serbisë shqiptarët e patën bojkotuar (Republički zavod za statistiku, , 2011). Ku edhe është regjistruar një numër shumë simbolik prej 5.809 shqiptarë. Qasja politike dhe institucionale e Qeverisë së Republikës së Serbisë ndaj problemeve të shqiptarëve etnik bazohet në rezultatet e këtij regjistrimi, qoftë në bisedime me liderët politikë e institucional – bisedime këto të filluar së fundmi rreth Programit “Masat urgjente për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve” të propozuar nga liderët shqiptarë, qoftë edhe në raport me zgjedhjet e Këshillit Kombëtar Shqiptar që me ligj po zvogëlon numri e anëtarëve të këtij institucioni nga 29 në 15 edhe pse Listën e veçantë zgjedhore për shqiptarë

ka të regjistruar mbi 27. 000 shqiptar si zgjedhës aktivë. Në vazhdim do të analizojmë dhe krahasojmë të dhënat ndër vite për shqiptarët e Luginës së Preshevës, të dhënat nga Enti i Republikan i Statistikave dhe krahasimi i të dhënave me këto të publikuara së fundmi.

Regjistrim i popullsisë në Republikën e Serbisë ishte paralajmëruar për 24 prill të vitit 2021. Për shkak të gjendjes me pandeminë globale Covid-19 ishte shtyrë me vendim të Qeverisë për në tetorin e vitit 2021 që me një vendim tjetër të Qeverisë obligohet Enti për Statistika të realizoj në tetorin e vitit 2022.

Të dhënat gjeografike për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

Presheva

Në skajin më jugor, në pozitën e bifurkacionit të derdhjes së ujërave në Detin e Zi dhe në Detin Egje, në lëndinën e lumit Moravica, shtrihet komuna e Preshevës, një zonë e pazhvilluar dhe me një dendësi të madhe të popullsisë, duke përfshirë hapësirën e Luginës së Preshevës dhe të brigjeve të saja malore. Në sipërfaqen prej 264 km² Presheva ka 35 vendbanime. Presheva gjendet në mes të brigjeve perëndimore të Malit të Zi të Shkupit, të brigjeve të malit Rujan dhe të Komunës së Bujanocit e Gjilanit. Në jug, Presheva kufizohet me Republikën e Maqedonisë, gjegjësisht është e hapur në drejtim të Luginës së Kumanovës. Përmes territorit të saj kalojnë korridoret më të rëndësishme të infrastrukturës rrugore: hekurudha dhe rruga magjistrale: Beograd – Nish – Shkup.

Bujanoci

Treva e komunës së Bujanocit në pjesën më të madhe është zonë kodrinore-malore, 2/3 e sipërfaqes së saj (përkatësisht 313 km²) shtrihet në lartësinë mbidetare prej mbi 500 m; ndërsa 1/3 (përkatësisht 148 km²) ka karakter të zonës së rrafshët. Konfiguracioni i volitshëm gjeomorfologjik i terrenit (50% e sipërfaqes) gjendet në intervalin 800-1000m lartësi mbidetare.

Medvegja

Komuna e Medvegjës shtrihet në kuadër të zonës malore-luginore të jugut të Serbisë në pjesën e epërme të lumit Jablanica, në një zonë kodrinore-malore, me një infrastrukturë periferike, të banuar rrallë dhe me migrim të theksuar. Rreth 10.760 banorë jetojnë në një sipërfaqe prej 524 km² në 44 vendbanime. Medvegja gjendet në mes të komunave të Kurshumlisë, Bojnikut, Lebanes, Podujevës, Kamenicës dhe Prishtinës.

Treva e Komunës së Medvegjës i takon një zone kodrinore-malore (95% e sipërfaqes shtrihet në lartësi mbidetare 400-1000m), me lugina lumore të thella dhe karstike. Kuotat më të ulëta të terrenit janë nën 400 m (316m) në luginën e lumit Jablanica, e më të lartat në malet Radan dhe Majdan (1.376m), ndërkaq brezat më të përhapura të lartësive malore shtrihen në intervalet prej 600-800m (44% e sipërfaqes së përgjithshme).

Trevat e komunave Bujanoc dhe Preshevë sipas ndarjes administrative të Republikës së Serbisë i takon Qarkut të Pčinjës, ndërkaq Komuna e Medvegjës i takon Qarkut të Jabllanicës.

PARTITË POLITIKE SHQIPTARE

Fryma e re politike e shkaktuar me rënien e murit të Berlinit edhe në ish Jugosllavi imponoi ndryshimet ligjore që mundësuan pluralizmin politik dhe sistemin shumë partiak.

Në Republikën e Serbisë popullsinë e përbëjnë 1/3 e minoriteteve, ndonëse 2/3 e partive politike të regjistruara janë parti politike të minoriteteve. Për derisa në institucionin më të lartë të shtetit – Parlament, minoritetet përfaqësohen me 8%.

Partitë e pakicave kombëtare shfaqin një shumëllojshmëri të angazhimeve programatike në mesin e partive politike shqiptare, nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt vetëm me çështjet e të drejtave të pakicave (Friedman, 2005). Andaj, përkufizimin e një partie me bazë etnike si parti politike shqiptare është "burimi i mbështetjes së saj nga shumica dërrmuese e një grupi të identifikueshëm etnik (ose grup të grupeve etnike), dhe shërben interesat e atij grupi" thotë Donald L. Horowitz në librin e tij "Grupet etnike në Konflikt" si dhe i konsideron disa nga ato organizata politike që garojnë në zgjedhje të përcaktuara nga legjislacioni nacional si diçka tjetër nga një parti politike². Partitë politike shqiptare ndryshojnë shumë nga partitë e pakicave tjera nga se janë të angazhuara "në vetë-prezantimin e tyre para audiencës së brendshme dhe ndërkombëtare" (Friedman, 2006), disa parti të tilla në mënyrë të qartë lidhin veten me grupe të cilën Christopher Lord mund të i quajë "gun-toting revolutionaries"³ (Lord, et al., 1993).

Padyshim, argumenti i fundit nuk qëndron nëse analizojnë programet politike të partive shqiptare në Luginën e Preshevës. Është e vërtetë që partitë politike shqiptare atëbotë përveç referendumit të 92-shit kanë dhënë mbështetje pa rezervë për UÇPMB-në qoftë në kuptimin politikë edhe në atë logjistikë, por, programet e të gjitha partive politike janë të motivuar nga standardet Evropiane dhe kërkesat e parashtuara për zhvillimin e proceseve demokratike në Luginën e Preshevës janë të kornizuara nga dokumentet dhe praktikat Evropiane⁴.

Megjithatë, edhe pse partitë politike nga Lugina e Preshevës dhe ato të Kosovës ishin në drejtime të ndryshme politike, ka pasur lidhje shumë të ngushta midis tyre; partitë e shqiptarëve të Luginës së Preshevës kanë gëzuar mbështetjen e çdo partie të ndryshme shqiptare në Kosovë. Përfaqësuesit e shqiptarëve të Luginës së Preshevës kanë marrë pjesë në konferenca partiake të partive të Kosovës si dhe ka pasur kontakte personale (Brunnbaue, 1999).

Ishte dhuna dhe diskriminimi i rëndë i regjimit të Millosheviqit që imponuan domosdoshmërinë e kundërpërgjigjes legale të Shqiptarëve me organizimin e pavarur politik me anë të LDK – së

² Legjislacionin për zgjedhje, Serbia, të cilin e ka adaptuar nga Bashkimi Evropian mundëson që partitë politike të pakicave kombëtare të regjistrohen me 1 mijë nënshkrime mbështetëse, për deri sa partitë politike regjistrohen me 10 nënshkrime mbështetëse të verifikuara ashtu siç është përkufizuar edhe në librin e Donald L. Horowitz

³ Revolucionar armë mbajtës aso me saktë pishtol mbajtës

⁴ Shih më gjerë: Programet politike dhe Kërkesat e Kuvendit të Këshilltarëve Shqiptarë të përkufizuar në Platformën e Përbashkët Politike të nxjerra me 14 janar 2006 në Preshevë. Gjithashtu, politikisht i referohen edhe dy ngjarjeve historikisht shumë të rëndësishme: Referendumit të 1 dhe 2 Mars 1992 dhe luftës së UÇPMB-së ku është kërkuar bashkëngjitja me Kosovën si pjesë e natyrshme e saj.

në Kosovë, me PPD në Maqedoni, me LD të Shqiptarëve në Mal të Zi dhe me Partinë për Veprim Demokratik (PVD) në Luginë të Preshevës e formuar me 19 gusht 1990⁵ si parti e parë politike që i tuboi në veprim të përbashkët politik Shqiptarët në Luginë të Preshevës. Në këto rrethana shoqërore e politike orientimet themelore politike të PVD – së ishin të orientuara në luftën politike kundër diskriminimit të rëndë që arrinte edhe përmasat e apartheidit dhe në angazhimin për realizimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave kolektive të parapara me Konventa ndërkombëtare (Halimi, 2015). Qëndrime të ngjashme ka mbajtur edhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) e cila lindi nga Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë të Preshevës dhe u quajt Partia e Bashkuar Demokratike Shqiptare e cila më vonë emërohet si Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) e veproi në Preshevë dhe Bujanoc.

Sot, shqiptarët në Luginën e Preshevës përfaqësohen nga një larmi e partive politike nga të cilat asnjëra nuk është e ndërlidhur me ndonjërin nga subjektet politike me qendër në Beograd apo në qendrat tjera të Serbisë dhe në vazhdimësi me fanatizëm ruajnë organizimin e pavarur politikë.

INSTITUCIONET PËRFAQËSUESE

Shqiptarët e Preshevës me vite e mbajnë pushtetin lokal dhe e qeverisin atë që nga 90-tat në Preshevë; në Bujanoc shqiptarët që nga viti 2002 e morën pushtetin lokal dhe ende e qeverisin; në Medvegjë e kanë të pamundshme për shkak të strukturës etnike.

Më vonë, rrethanat politike në Luginë të Preshevës e detyruan klasën politike që të themelojnë edhe një organ jo formal: Kuvendin e Këshilltarëve Shqiptarë që luajti një rol pozitiv në rrethanat e përmendura aktuale politike në Luginë, u bë një bosht unifikimi i kërkesave dhe i shpresave politike të Shqiptarëve të Luginës. Por si duket edhe ky institucionalizim sikur edhe disa të tjera do të harrohet, sepse dalin alternativa të reja politike (Muharremi, 2012) nga viti 2010 kanë formuar edhe Këshilli Kombëtar Shqiptar⁶, i cili fushëveprimin politik e shtrihen në ruajtjen dhe avancimit të identitetit kombëtar të shqiptarëve.

Ndërkaq në Parlamentin Republikan Luginë e Preshevës prej zgjedhjeve të para parlamentare të vitit 1990 deri më tani në shtatë përbërje të Parlamentit qendrorë kishte përfaqësuesit e vet.

PËRFAQËSIMI NË PARALMENTIN E REPUBLIKËS SË SERBISË

- në zgjedhjet e vitit 1990 - një deputet i PVD – së, Behlul Nasufi
- në zgjedhjet e vitit 1993 – dy deputet, Behlul Nasufi i PVD dhe Tahir Dalipi PDSH
- në zgjedhjet e vitit 1997 – një deputet të koalicionit PVD dhe PDSH, Ramadan Ahmeti
- në zgjedhjet e vitit 2007 – një deputet i Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës së Preshevës, PVD dhe BDL, Riza Halimi
- në zgjedhjet e vitit 2008 – një deputet të Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës së Preshevës, PVD, UDSH dhe LPD, Riza Halimi

⁵ Intervistë me kryetarin e Partisë për Veprim Demokratik, Riza Halimi (19.06.2015)

⁶ Ligji mbi Këshillat kombëtare të pakicave nacionale, Beograd, 2007

- në zgjedhjet e vitit 2012 – një deputet të Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës së Preshevës, PVD, UDSH, LPD dhe BDL Riza Halimi dhe
- në zgjedhjet e vitit 2014 – dy deputet të PVD – së, Riza Halimi dhe Shaip Kamberi
- në zgjedhjet e vitit 2016 – një deputet të PVD-së, Fatmir Hasani.
- **në zgjedhjet e vitit 2020 – tre deputet: Shaip Kamberi PVD, Argjent Bajrami APN, Nadie Beqiri PD, që aktualisht ushtrojnë këtë funksion.**

PËRFAQËSIMI NË KËSHILLIN KOMBËTAR SHQIPTAR

- Në zgjedhjet e vitit 2010 themelohet Këshilli Kombëtar Shqiptar – kryetar Galip Beqiri (PVD)
- Në zgjedhjet e vitit 2015 Këshilli Kombëtar Shqiptar – kryetar Jonuz Musliu (LPD) pas vdekjes së tij, këtë funksion e ka ushtruar nga viti 2018 – kryetar Shukri Ymeri (PDSH)
- **Në zgjedhjet e vitit 2018 Këshilli Kombëtar Shqiptar – kryetar Ragmi Mustafa (PVD) si dhe aktualisht ushtron këtë funksion.**

Këshilli Kombëtar Shqiptar nga zgjedhjet e fundit (2018) përfaqësohet me kaq anëtar në këtë përbërje të partive politike :

PVD	6
APN	4
PDSH	2
PD	2
LR PDSH	1

Në koalicion qeverisës PVD dhe PDSH, ndërkaq në opozitë APN, PD dhe LRPDSH.

PËRFAQËSIMI I KOMUNËS SË PRESHEVËS

- në zgjedhjet e vitit 2002 – kryetar i komunës Riza Halimi – PVD revokohet në vitin 2004
- në zgjedhjet e vitit 2005 – kryetar i komunës Ragmi Mustafa - PDSH
- në zgjedhjet e vitit 2008 – kryetar i komunës Nader Sadiku - PVD pas revokimit vitin 2009 – kryetar i komunës Ragmi Mustafa - PDSH
- në zgjedhjet e vitit 2012 - kryetar i komunës Ragmi Mustafa - PDSH
- në zgjedhjet e vitit 2016 – kryetar i komunës Shqiprim Arifi – APN pas revokimit vitin 2017- kryetare e komunës Ardita Sinani – PVD
- në zgjedhjet e vitit 2021- kryetar i komunës Shqiprim Arifi – APN
- **në zgjedhjet e vitit 2021- kryetar i komunës Ardita Sinani – PVD aktualisht ushtron këtë funksion**

Komuna e Preshevës nga zgjedhjet e fundit (2021) për Kuvend Komunal përfaqësohet me këta asamblastë:

APN	14
PDSH	9
PVD	7
LR	5
UDSH	1

Në koalicion qeverisës PVD, PDSH, LR dhe UDSH, ndërkaq në opozitë APN dhe Lista Serbe.

PËRFAQËSIMI I KOMUNËS SË BUJANOCIT

- në zgjedhjet e vitit 2002 – kryetar i komunës Nagip Arifi - PVD
- në zgjedhjet e vitit 2006 – kryetar i komunës Nagip Arifi – PVD
- në zgjedhjet e vitit 2008 – kryetar i komunës Shaip Kamberi - PVD
- në zgjedhjet e vitit 2012 – kryetar i komunës Nagip Arifi – PD
- në zgjedhjet e vitit 2016 – kryetar i komunës Shaip Kamberi -PVD
- **në zgjedhjet e vitit 2020 – kryetar i komunës Nagip Arifi – PD aktualisht ushtron këtë funksion.**

Komuna e Bujanocit nga zgjedhjet e fundit (2016) për Kuvend Komunal përfaqësohet me këta asamblastë:

PVD	8
PD	10
LPD	4
APN	3
UDSH	1

Në koalicion qeverisës PVD, PD, LPD dhe APN në fillim ndërkaq në doli në opozitë me UDSH ku ishin edhe SNS dhe Lista Stojanca Arsic.

PËRFAQËSIMI I KOMUNËS SË MEDVEGJËS

- në zgjedhjet e vitit 2002 –
 - në zgjedhjet e vitit 2006 –
 - në zgjedhjet e vitit 2008 - zv/kryetar i komunës Florim Sahiti - PVD
 - në zgjedhjet e vitit 2012- zv/kryetar i komunës Florim Sahiti – PVD
 - pas vdekjes së kryetarit 2015 kryetar i komunës Florim Sahiti – PVD
 - në zgjedhjet e vitit 2015 –
 - në zgjedhjet e vitit 2019 –
- aktualisht asnjë përfaqësues politik shqiptar nuk ka asnjë funksion.**

Komuna e Medvegjës nga zgjedhjet e fundit (2019) për Kuvend Komunal përfaqësohet me këta asamblistë:

PVD	1	275
AFFEDS +GQ FEHMI BEHA	2	392

Të gjithë janë në opozitë.

TABELAT DHE FIGURAT

Të gjitha të dhënat të përpunuar në përfaqësues dhe votë, si dhe të detajuara edhe në përqindje janë të pasqyruara në mënyrë tabelore si në vijim:

PËFAQËSIMI NË KUVENDET KOMUNALE PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË					
Subjektet shqiptare		ASEMBLESIT	VOTA	% sipas perfaqësimit	% sipas votës
PVD		16	7347	25.40%	24.14%
APN		17	7956	26.98%	26.14%
PDSH		9	4848	14.29%	15.93%
PD		10	5723	15.87%	18.80%
LPD		4	1965	6.35%	6.46%
LR		5	2601	7.94%	8.54%
AFEDS+GG FEHMI BEHA		2	0	3.17%	0.00%
TOTALI		63	30440	100.00%	100.00%

Tab.1.




Fig 1.

KUVENDI KOMUNAL NË PRESHEVË

KUVENDI		ASEMBLESIT	VOTA		
KUVENDI		38	18273		
<i>Subjektet shqiptare</i>					
	ASEMBLESIT	VOTA	% sipas perfaqësimit	% sipas votës	
PVD	7	3345	19.44%	19.62%	
APN	14	6102	38.89%	35.79%	
PDSH	9	4121	25.00%	24.17%	
LR	5	2601	13.89%	15.25%	
UDSH	1	479	2.78%	2.81%	
ADSH	0	403	0.00%	2.36%	
TOTALI	36	17051	100.00%	100.00%	
<i>Subjektet serbe</i>					
LS	2	1222	100.00%	100.00%	
TOTALI	2	1222	100.00%	100.00%	

Tab 2.




Fig 2.

KUVENDI KOMUNAL NË BUJANOC

		ASEMBLESIT	VOTA		
<i>KUVENDI</i>		41	20958		
<i>Subjektet shqiptare</i>		ASEMBLESIT	VOTA	% sipas perfaqësimit	% sipas votës
	PVD	8	3727	30.77%	28.40%
	PD	10	5048	38.46%	38.46%
	LPD	4	1965	15.38%	14.97%
	APN	3	1658	11.54%	12.63%
	UDSH	1	727	3.85%	5.54%
	TOTALI	26	13125	100.00%	100.00%
<i>Subjektet serbe</i>	SNS	10	4968	76.92%	74.98%
	SPS STOJNCA	3	1658	23.08%	25.02%
	TOTALI	13	6626	100.00%	100.00%
<i>Subjektet serbe</i>	ROM1	1	671	50.00%	55.59%
	ROM2	1	536	50.00%	44.41%
	TOTALI	2	1207	100.00%	100.00%

Tab 3.




Fig 3.

KUVENDI KOMUNAL NË MEDVEGJË

KUVENDI	ASEMBLESI	VOT			
	T	A			
	25	4263			
Subjektet shqiptare	ASEMBLESI	VOT	% sipas perfaqësimit	% sipas votës	
	T	A			
	PVD	1	275	33.33%	41.23%
	APN	0	0	0.00%	0.00%
	PD	0	0	0.00%	0.00%
	LPD	0	0	0.00%	0.00%
	PDSH	0	0	0.00%	0.00%
	AFFEDS + GG FEHMI BEHA	2	392	66.67%	58.77%
	LR	0	0	0.00%	0.00%
	TOTALI	3	667	100.00%	100.00%
Subjektet serbe	SNS	18	2764	81.82%	76.86%
	PUPS	1	254	4.55%	7.06%
	SRS	2	305	9.09%	8.48%
	SD	1	273	4.55%	7.59%
	TOTALI	22	3596	100.00%	100.00%

Tab 4.




Fig 4.

KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR NË SERBI				
	ANËTAR	VOTA	% sipas perfaqësimit	% sipas votës
PVD	6	4719	40.00%	33.39%
APN	4	3723	26.67%	26.34%
PDSH	2	1725	13.33%	12.21%
PD	2	2358	13.33%	16.68%
LR PDSH	1	1223	6.67%	8.65%
LPD	0	0	0.00%	0.00%
AFEDS	0	385	0.00%	2.72%
TOTALI	15	14133	100.00%	100.00%

Tab.5.



Fig 5.

DEPUTET NË PARLAMENTIN REPUBLIKAN TË SERBIË					
Subjektet shqiptare		DEPUTET	VOTA	% sipas perfaqësimit	% sipas votës
	PVD	1	26437	0.40%	0.85%
	APN	1			
	PD	1			
Subjektet serbe dhe të tjerë		247	3074171	98.80%	99.15%
	TOTALI	250	3100608	100.00%	100.00%

Tab.6.

PËRFAQËSUES NË TË GJITHA INSTITUCIONET E ZGJEDHURA						
	KK	KKSH	PS	TOTALI	VOTA	
PVD	16	6	1	23	12066	27.07%
APN	17	4	1	22	11679	26.20%
PDSH	9	2	1	12	6573	14.75%
PD	11	2	0	13	8081	18.13%
LR	5	1	0	6	3824	8.58%
LPD	4	0	0	4	1965	4.41%
AFFEDS	1	0	0	1	385	0.86%
TOTALI	63	15	3	81	44573	100.00%

Tab.7.

Këshilli Kombëtar Shqiptar

Literatura

Brunnbaue, U., 1999. The forgotten Albanian Serbian - State of the ethnic Albanians in southern Serbia outside Kosovo. *Journal of Contemporary Research*, Issue South-East Europe, pp. 7-12.

Friedman, E., 2005. *Electoral System Design and Minority Representation in Slovakia and Macedonia*. no. 4 re. Scopje: Ethnopolitics 4.

Friedman, E., 2006. *MINORITY POLITICAL PARTIES IN EASTERN EUROPE: ALBANIAN AND MAGYAR DIASPORA PARTIES COMPARED*, Skopje: Regional Representative European Centre for Minority Issues.

Halimi, R., 2015. *Kryetar i Partisë për Veprim Demokratik* [Intervista] (19 06 2015).

Islami, H., 1971. *E vërteta mbi Shqiptarët në disa vepra antropogjeografike*. Prishtinë: Dituria.

Ismajli, R., 1970. *Mbi disa toponime në Serbi të Jugut dhe në Maqedoni të Veriut, Gjurmime Albanologjike*. nr.1-2 re. Prishtinë: s.n.

Lord, C., Frič, P., Gál, F. & Hunčík, P., 1993. *The International Perspective. The Hungarian Minority*. Prague: Institute of Social and Political Science.

Muharremi, I., 2012. *Mos Harro...!*. Medvegjë: Trojet.

Republički zavod za statistiku, , 2011. *Popis Stanovništva*. Beograd: Republički zavod za statistiku, .

Salihu, X., 2015. *LUGINA E PRESHEVËS, KRISTIANIZMI, PËRHAPJA E FESË ISLAME DHE STRUKTURA E SAJ NACIONALË*. [Në linjë]

Available at: <http://www.kosovalindore.com/>

[Qasja 20 06 2015].

Фонд за хуманитарно право, 2004. *Албанци у Србији*. Београд : Фонд за хуманитарно право.